



**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

www.tenniskosova.com

Në bazë të nenit 26 të Ligjit për Sport (04/L-075 21 Dhjetor 2011), Kuvendi i Federatës së Tenisit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 14 Janar 2012, aprovoi këtë:

Statut të Federatës së Tenisit të Republikës së Kosovës

Përmbajtja

1. Emri, Forma dhe Adresa.....	3
2. Qëllimet dhe detyrat e Federatës.....	4
3. Anëtarët e Federatës.....	4
4. Organet drejtuese të Federatës.....	6
5. Kuvendi.....	6
6. Bordi Ekzekutiv.....	7
7. Kryetari.....	9
8. Sekretari i përgjithshëm.....	10
9. Këshilli mbikëqyrës.....	10
10. Këshillat dhe Komisionet e Bordit Ekzekutiv.....	11
11. Garat.....	14
12. Reprerentacionet.....	14
13. Dispozitat financiare.....	15
14. Shërbimi Administrativo-Profesional.....	15
15. Rregulloret e brendshme.....	16
16. Dopingu.....	17
17. Dispozitat kalimtare dhe të fundit.....	17

1. Emri, Forma dhe Adresa

- 1.1. Federata e Tenisit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm Federata ose FTK) është asociacion vullnetar i shoqatave dhe organizatave të cilat për veprimtari themelore kanë sportin e tenisit.
- 1.2. Federata është person juridik dhe vepron në pajtim me Ligjin për Sport, Ligjin mbi Organizatat jofitimprurëse dhe mbi normat dhe rregullat e përcaktuara nga ETF dhe ITF. Federata e ka xhirollogarinë e vetë.
- 1.3. Emri i federatës është Federata e Tenisit të Kosovës, shkurtesa është FTK. Selia e Federatës është në Prishtinë. Federata vepron në territorin e Kosovës.
- 1.4. Federata e ka logon, vulën dhe flamurin e vet. Logoja është e përbërë prej reketit dhe topit. Logoja e Federatës është e mbrojtur dhe mund të përdoret vetëm me lejen e Bordit të Federatës.
- 1.5. Flamuri i Federatës ka formën e njëjtë sikurse logoja.
- 1.6. Federata e ka vulën katrore dhe të rrumbullakët, me logon e Federatës dhe me tekstin:
FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS.
KOSOVO TENNIS FEDERATION.
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
- 1.7. Selia-Zyra e Federatës së Tenisit të Kosovës është në Prishtinë, Adresa:

FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS
Shtëpia e Sporteve
Rr. "Agim Ramadani" Nr. 43 Prishtinë

- 1.8. FTK ka numër të xhirollogarisë në Bankën e re të Kosovës në Prishtinë.

ADRESA: Rr, Nëna Terezë 54, Fahu Postal 235, 10000 Prishtinë, Kosovë/0
KODI BANKAR:
XHIROLLOGARIA: Federata e Tenisit të Kosovës : 1210271200072424
VALUTA: EUR
BANKA PROFITABILE: BANK SLOVENIAN CREDITANSTALT
SWIFT: BKAUATWW
ACCOUNT:

- 1.9. Federata është anëtare e Komitetit Olimpik të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm AOK).
Federata punon ne bazë të akteve normative të veta.
Federata mund të anëtarësohet edhe në asociacione të tjera sportive vendore dhe ndërkombëtare dhe është në përputhje me rregullat dhe dispozitat nga ETF dhe ITF.
- 1.10. Federata përfaqësohet nga Kryetari ose nga personi i autorizuar nga Kryetari.
- 1.11. Federata bashkëpunon me Ministrinë e Rinisë Kulturës dhe Sportit (Departamenti i Sportit), Shoqatën e Referëve dhe Trajnerëve, Fakultetin e Edukatës Fizike, Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe shoqatat tjera që duan të bashkëpunojnë (edhe ato josportive).
- 1.12. Federata e njofton opinionin publik për punën e saj nëpërmjet: Informatorëve, mjeteve të informimit si dhe nëpërmjet organizimit të konferencave për media. Anëtarët e vetë i njofton nëpërmjet:
- Proceverbaleve të mbledhjeve të organeve dhe komisioneve,
 - Informatorëve dhe publikimeve tjera dhe
 - Mjeteve të informimit.

2. Qëllimet dhe detyrat e Federatës

- 2.1. Qëllimet e Federatës janë: masovizimi, zhvillimi kualitativ dhe organizimi i tenisit, udhëheqja e garave zyrtare dhe garave të tjera.
- Udhëheqja me Reprerentacionet e Tenisit të Kosovës,
 - Organizmi dhe përparimi profesional i lojtarëve, trajnerëve, referëve, delegatëve.
 - U ndihmon organizatave të tjera në promovimin e tenisit në të gjitha fushëveprimet e sportit të tenisit në përputhje me aktet normative.
 - Merr pjesë në manifestime dhe gara ndërkombëtare,
 - Mbështet zhvillimin e tenisit në vise të pazhvilluara,
 - Merr pjesë në punën e AOK-ut dhe asociacioneve tjera sportive,
 - Vepron kundër përdorimit të dopingut ,në përputhje me normat ndërkombëtare.
 - Merr pjesë në punën e organizatave të tjera sportive ndërkombëtare, të cilat janë të lidhura me tenis.

3. Anëtarët e Federatës

- 3.1. Anëtarë të Federatës janë: Klubet e tenisit(publike dhe private), Shoqata e trajnerëve, Shoqata e referëve, Shoqata e lojtarëve dhe të gjitha shoqatat tjera të cilat do të pranohen nga Federata. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për anëtarësim në Federatë janë:

- Deklarata me shkrim e Shoqatës, klubit për aplikimin dhe respektimin e Statutit dhe akteve tjera normative.
- Vërtetimi për regjistrim i Shoqatës, klubit,
- Emrat e personave të autorizuar për përfaqësim,
- Numri i xhirollogarisë,

Bordi i Federatës i pranon anëtarët e rinj në anëtarësi të Federatës.

3.2. Zhvillimi i tenisit duke i organizuar sportistët, aktivistët sportiv dhe anëtarët e tjerë që janë të përfshirë në Federatë me vullnetin e tyre, bëhet në klube. Klubet janë pjesë e departamenteve të sporteve në komunat e tyre përkatëse.

Organizimi, të drejtat dhe detyrat e shoqatave të tenisit janë te rregulluara me status dhe aktet tjera normative të FTK-së dhe gjithashtu me rregullat ndërkombëtare të tenisit.

Klubet të cilat janë të formuara dhe regjistruara në organet përkatëse komunale, duhet ta posedojnë infrastrukturën e nevojshme (fushat), ekipin profesional dhe certifikatën e regjistrimit të klubit, në pajtueshmëri me statutin.

3.3. Shoqatat e trajnerëve, referëve dhe organizatave që kanë lidhje me Federatën, të drejtat dhe detyrimet e tyre, duhet të jenë në pajtueshmëri me rregullat dhe statutet e FTK, ETF dhe ITF dhe aktet tjera normative të sjella nga FTK.

3.4.

3.4.1. Shoqatat e Referëve dhe Trajnerëve të Kosovës, si dhe Shoqata Profesionale e Federatës, i formojnë organizatat profesionale të tenisit, në nivel komunal.

Shoqatat e Trajnerëve dhe Referëve i zbatojnë politikat e tyre në pajtueshmëri me vendimet e aprovuara nga organet e Federatës. Shoqatat e Trajnerëve dhe Referëve janë të obliguara të raportojnë në formë të shkruar tek Bordi i FTK-së, në lidhje me aktivitetin operacional dhe financiar të tyre çdo 6 muaj.

Ata janë gjithashtu të obliguar të raportojnë tek Kuvendi i FTK-së në lidhje me aktivitetin operacional dhe financiar të tyre, çdo vit, në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të FTK-së. Statuti i Shoqatës së Trajnerëve dhe Referëve duhet të jetë në pajtueshmëri me dispozitat e këtij statuti.

3.4.2. Aktiviteti sportiv i referëve të tenisit, është i bazuar në amatorizëm, përderisa kompensimi për referim është i rregulluar me aktet normative specifike, të cilat janë të aprovuara nga Bordi i FTK-së.

3.4.3. Trajnerët dhe profesionistët e tjerë, i zbatojnë të drejtat e tyre, drejtpërdrejt nga klubet – organizatat e tenisit dhe punëdhënësit e tyre, bazuar në rregullat e tyre në bazat amatore. Trajnerët duhet të kenë dokumentin kualifikues të lëshuar nga organet kompetente të FTK-së, ETF-së, ITF-it dhe PTR-së, në mënyrë që të punojnë si trajnera nëpër klube të tenisit. Lëshimi apo refuzimi i licencës së trajnerëve është i rregulluar nga

aktet normative të Shoqatës së Trajnerëve dhe Rregullat Profesionale të Bordit të FTK-së, derisa të krijohen kushtet tjera.

3.5. Nëse Shoqata e Trajnerëve dhe Referëve nuk punojnë në pajtueshmëri me Statutin dhe Aktet Normative të FTK-së, aktiviteti i tyre do të suspendohet automatikisht nga bordi i FTK-së, derisa të krijohen kushtet tjera të punës.

3.6. Çdo anëtar i Federatës duhet ta paguaj anëtarësinë vjetore të cilën e cakton Bordi. Anëtar i mundë të dalë nga Federata atëherë kur i kryen të gjitha obligimet financiare ndaj Federatës dhe anëtarëve të saj. Anëtar i mundë të përjashtohet nga Federata kur i thyen dispozitat e Statutit dhe akteve tjera normative të Federatës. Vendimin për përjashtim nga anëtarësia e bie Kuvendi. Efektet e përjashtimit veprojnë nga dita e marrjes së Vendimit.

4. Organet e Federatës

4.1. Organet e Federatës janë:

- Kuvendi
- Bordi
- Kryetari
- Këshilli mbikëqyrës

5. Kuvendi

5.1. Kuvendi është organi më i lartë i Federatës i cili përbëhet prej anëtarëve të autorizuar të klubeve dhe Shoqatave të Federatës. Klubet dhe Shoqatat përfaqësohen në Kuvendin e Federatës me nga tre delegatë. Në mbledhjet e Kuvendit mundë të marrin pjesë delegatët e autorizuar dhe mysafirët e ftuar pa të drejtën e votës.

5.2. Mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Kuvendi i rregullt mbahet çdo vitë, e thërret Kryetari ose Bordi i FTK-ës. Kuvendin e jashtëzakonshëm mund ta thërrasin Kryetari, 2/3 e anëtarëve të Kuvendit, 2/3 e anëtarëve të Bordit dhe Këshilli mbikëqyrës. Ftesa duhet të dërgohet më së largu 15 ditë para mbledhjes, ndërsa materiali 7 ditë para Kuvendit. Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të vendosë vetëm për çështjet për të cilat është thirrur. Kuvendin e jashtëzakonshëm duhet ta konvokoj Kryetari në afat prej 30 ditëve prej ditës së kërkesës, në të kundërtën kuvendin mundë ta konvokojë edhe inicuesi.

5.3. Kuvendi mundë të bie vendime në qoftëse, janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve të Kuvendit.

5.4. Kuvendi zgjedh kryesinë e punës, procesmbajtësin, komisionin verifikues dhe në qoftëse ka nevojë edhe trupa tjera punuese. Në mbledhje mbahet procesverbali të cilin e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e kryesisë së punës dhe procesmbajtësi. Kuvendi merr vendime me shumicën e anëtarëve prezent të cilët e kanë të drejtën e votës. Në qoftë se vendoset për ndryshimet statutare, ose për pushimin e punës së Federatës për një gjë të tillë duhet të votojnë 2/3 e anëtarëve prezent. Votimi është publik në qoftëse Kuvendi nuk vendos ndryshe. Kuvendin e udhëheq kryesia e punës, të cilën e përbëjnë: Kryetari i Federatës dhe dy anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi. Vendimet e Kuvendit janë të obligueshme për të gjithë anëtarët dhe organet e Federatës. Procedura dhe mënyra e punës së Kuvendit, më përfaqësisht rregullohen me Rregullorën e punës së Kuvendit.

5.5. Shpenzimet e pjesëmarrjës në mbledhje të Kuvendit i bartë vetë anëtari i Kuvendit.

5.6. Kuvendi në veprimtarinë e vetë i kryen këto punë:

- Aprovon statutin,
- Miraton raportet e punës të organeve të veta,
- Zgjedhë dhe shkarkon Kryetarin, dy nënkryetare dhe anëtarët tjerë të Bordit,
- Zgjedhë dhe shkarkon Këshillin mbikëqyrës,
- Vendosë në lidhje me mjetet e jashtëzakonshme juridike,
- Vendos mbi faljen e dënimeve,
- Aprovon planin financiar të Federatës
- Sajon politiken e Federatës,
- Kryen edhe punë tjera në përputhje me Statutin dhe aktet tjera të Federatës.

6. Bordi Ekzekutiv

6.1. Bordi ekzekutiv (në tekstin e mëtutjeshëm-Bordi) udhëheq me punën e Federatës në mes të dy mbledhjeve të Kuvendit. Mbledhjet i thërret Kryetari e në mungesë të tij njëri prej dy nënkryetarëve ose Sekretari i përgjithshëm. Mbledhjet janë të rregullta ose të jashtëzakonshme, mbledhja e jashtëzakonshme mund të konvokohet nëse për një gjë të tillë deklarohet shumica e anëtarëve të Bordit.

6.2. Bordi numëron 11 anëtarë dhe përbëhet prej: Kryetarit, dy nënkryetarëve dhe tetë anëtarëve tjerë, prej të cilëve pesë zgjedhën nga kuvendi, ndërsa tre emërohen nga Kryetari. Anëtarët e Bordit zgjedhën nga Kuvendi me mandat katër vjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat. Në Bordin e Federatës duhet të jenë të përfaqësuar edhe minoritetet dhe femrat në përputhje me dispozitat e Ligjit për Sportin.

6.3. Kryetari dhe dy nënkryetarët janë të zgjedhur për mandatin katër vjeçar, 5 anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi kanë mandat katër vjeçar, derisa tre anëtarë e zgjedhur nga Kryetari kanë mandat dyvjeçar.

Kryetari i Shoqatës së trajnerëve dhe referëve, automatikisht janë anëtarë të kryesisë së FTK-së.

Prej numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit, 30% duhet të jenë femra, dhe 10% nga minoritetet e Kosovës.

Anëtarët e Bordit zgjedhën me vota të fshehta. Lista përfshin emrat e kandidatëve dhe postet e tyre në Bord. Kandidati që mban për një post, nuk mund të mbajë post të dytë. Kryetari i Bordit është edhe Kryetar i Kuvendit.

6.4. Mënyra e punës dhe procedura e vendimmarrjes në Bordin e FTK-ës, përafërsisht rregullohen me Rregulloren mbi Punën e Bordit.

6.5. Bordi në veprimtarinë e punës së vetë kryen këto punë:

- Propozon Statutin dhe aktet tjera Kuvendit,
- Përgatit mbledhjet e Kuvendit dhe materialin përcjellës,
- Ekzekuton vendimet e Kuvendit,
- Aprovon listën e zyrtareve të ndeshjeve dhe rregulloret e brendshme të Federatës,
- Përpilon planin e punës dhe atë financiar të Federatës,
- Vendos për blerjen ose shitjen e pasurisë së Federatës,
- Emëron dhe shkarkon Sekretarin e përgjithshëm,
- Aprovon planprogramin e punës së Këshillit profesional,
- Emëron dhe shkarkon trajnerët e reprezentacioneve,
- Emëron dhe shkarkon Komisararin e garave,
- Aprovon raportet e Këshillave dhe Komisioneve të Bordit,
- Miraton sistemin e garave, kalendarin dhe propozicionet e garave,
- Bartë të drejtën e organizimit të garave nën ombrellën e Federatës,
- Cakton lartësinë e anëtarësisë dhe kuotizimeve për anëtarët e Federatës,
- Cakton lartësinë e taksës për zyrtarë të ndeshjeve,
- Vendosë për pranimin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve në Federatë dhe për lartësinë e pagave të tyre,
- Emëron dhe shkarkon Këshillat dhe Komisionet e Bordit,
- Vendos edhe për çështjet tjera të cilat nuk janë në kompetencë të Kuvendit.

6.6. Bordi mund të formojë komisione të përhershme dhe ad hock, vendos për kompetenca të tyre dhe emëron anëtarët e tyre. Komisionet dhe këshillat për punën e tyre i përgjigjen Bordit.

Komisionet-Këshillat e përhershme janë:

- Këshilli profesional,
- Komisioni-komisari i garave,
- Këshilli i garave (si organ i nivelit të dytë)
- Komisioni Disiplinor.
- Komisioni për kalimin dhe regjistrimin e lojtarëve,
- Komisioni për çështje të referimit dhe rregulla të lojës,
- Komisioni i Akteve Normative
- Komisioni për Informim dhe Marketing
- Komisioni Sanitar dhe
- Komisioni për shpërndarjen e çmimeve

7. Kryetari i Bordit

Kryetarin dhe dy nënkryetarët i zgjedh Kuvendi me mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Njëri nga nënkryetarët duhet të jetë nga radhët e pakicave.

Kryetari në veprimtarinë e vetë kryen këto punë:

- Thirr mbledhjet e Bordit, udhëheq Bordin dhe mbledhjet e Bordit
- Përfaqëson Bordin dhe FTK-në në mbledhjet ndërkombëtare,
- Nënshkruan vendimet e Bordit dhe të Kuvendit
- Urdhëron ekzekutimin e planit financiar,
- Kujdeset për ligjshmërinë e punës së Federatës,
- Ka të drejtën e votës në vendimet e Bordit dhe organeve tjera deri në mbledhjen e parë të kuvendit
- Merr vendime në rrethana të jashtëzakonshme, kur Bordi apo Kuvendi nuk mund të mbledhen dhe informon këto organe, sa më shpejt të jetë e mundur.
- Ka të drejtën e shkarkimit të ndonjë anëtari të bordit, nëse ai nuk është aktiv, ose veprimet e tij janë në kundërshtim me Aktet normative të KTF-së. Ky vendim është në fuqi, deri në mbledhjen e parë të Kuvendit
- Kontrollon zbatimin e vendimeve të Kuvendit dhe Bordit,
- Konvokon dhe udhëheq mbledhjet e Kuvendit dhe të Bordit dhe konvokon mbledhjet Këshillave dhe Komisioneve,
- Zbaton dhe e udhëheq politikën e Federatës,
- Kryen edhe punë tjera të cilat dalin nga ky Statut dhe vendimet e Kuvendit dhe Bordit.
- Kryetari mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit nëse vërtetohet se ka punuar në kundërshtim me Statutin.
- Shkarkimi i tij vendoset me vota, nëse 2/3 e delegatëve të pranishëm votojnë pro.
- Propozon Sekretarin e FTK-së

8. Sekretari i përgjithshëm

8.1. Sekretarin e përgjithshëm e emëron Bordi me mandat katër vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

8.2. Sekretari i përgjithshëm në veprimtarinë e vetë i kryen këto punë:

- Udhëheq me punën e zyrës së Federatës,
- Ekzekuton vendimet e Kuvendit, Bordit dhe të Komisioneve të Federatës,
- Realizon bashkëpunimin me Federatat dhe organizatat tjera sportive jashtë Kosovës,
- Realizon bashkëpunimin me AOK-un, Departamentin e Sporteve dhe organizatat tjera sportive në Kosovë,
- Përgatitë mbledhjet e Kuvendit, Bordit , të Këshillave dhe Komisioneve,
- Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e organeve, Këshillave dhe komisioneve të Federatës ne cilësinë e këshillëdhënësit.
- Mban kontakte me mjetet e informimit,
- Propozon Bordit, profilin e bashkëpunëtorëve profesional-administrativë,
- Kryen edhe punë tjera të cilat dalin nga aktet tjera normative të FTK-së.

8.3. Sekretari i përgjithshëm themelon marrëdhënie të punës me Federatën në bazë të Ligjit mbi marrëdhënie të punës. Sekretari i përgjithshëm mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit të tij, në qoftë se nuk i kryen obligimet të cilat dalin nga aktet normative. Sekretarin e përgjithshëm në rast të mungesës së tij e zëvendëson personi të cilin e cakton Bordi.

9. Këshilli mbikëqyrës

9.1. Këshilli mbikëqyrës përbëhet prej tre anëtarëve. Këshillin mbikëqyrës e zgjedh Kuvendi me mandat katër vjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat. Anëtari i këshillit mbikëqyrës nuk mundë të jetë anëtarë i organeve dhe trupave të Federatës.

9.2. Bordi dhe të gjitha trupat e tij janë të obliguara që Këshillit mbikëqyrës ti a mundësojnë mbikëqyrjen në punën e tyre. Këshilli mbikëqyrës përcjell ligjshmërinë punës se Bordit, organeve dhe trupave në mes të dy Kuvendeve dhe mbikëqyr afarizmin financiar të Federatës. Këshilli mbikëqyrës i raporton për punën e vetë Kuvendit të FTK-së. Mënyra e punës së Këshillit mbikëqyrës më për afërsisht përcaktohet me Rregulloren mbi punën e Këshillit mbikëqyrës.

10. Këshillat dhe komisionet e Bordit Ekzekutiv

10.1. Këshilli Profesional

10.1.1. Këshilli profesional është organ profesional i Federatës, i cili kujdeset për zhvillimin profesional të tenisit. Këshilli profesional numëron tre anëtarë, të cilët i emëron Bordi me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandat. Për punën e vetë i përgjigjet Bordit.

10.1.2. Të drejtat dhe obligimet e Këshillit Profesional janë:

- Të përcjellë zhvillimin e tenisit brenda dhe jashtë,
- Të mbikëqyrë realizimin e planprogrameve të aprovuara nga Bordi,
- Kujdeset për zhvillimin profesional dhe popullarizimin e tenisit,
- Bashkëpunon me organizatat profesionale dhe shkencore me qëllim të përparimit të punës profesionale,
- Propozon Bordit emërimin dhe shkarkimin e trajnerëve të Reprerentacioneve,
- Kujdesët për përparimin profesional të trajnerëve,
- Propozon Bordit aprovimin e planprogrameve për zhvillimin e tenisit,
- Propozon sistemet e garave për të gjitha grupmoshat,
- Kryen edhe punë tjera me të cilat i ngarkon Bordi.

10.1.3. Të gjitha vendimet në Këshillin Profesional merren me shumicë votash. Këto vendime janë të plotfuqishme nëse janë prezent në mbledhje më tepër se gjysma e anëtarëve.

10.2. Komisioni për Regjistrim

10.2.1. Komisioni për regjistrim numëron tre anëtarë, të cilët i emëron Bordi me mandat katër vjeçar ,me të drejtën rizgjedhjes edhe për një mandat. Komisioni për kalimin dhe regjistrimin e lojtarëve regjistron lojtarët gjatë afateve kalimtare dhe vendos për çështjet statusore të lojtarëve. Komisioni merr vendime me shkrim për regjistrimin ose mos-regjistrimin e lojtarëve gjatë afateve kalimtare. Komisioni i merr vendimet në bazë të Rregullores për kalimin dhe regjistrimin e lojtarëve dhe Ligjeve në fuqi. Statusi i lojtarëve rregullohet më përafërsisht me Rregulloren për kalimin dhe regjistrimin e lojtarëve.

10.2.2. Të gjitha vendimet në Komisionin për Regjistrim merren me shumicë votash. Këto vendime janë të plotfuqishme nëse janë prezent në mbledhje më tepër se gjysma e anëtarëve.

10.3. Komisioni Arbitrar

10.3.1. Komisioni arbitrar përbëhet nga tre anëtarë të cilët i emëron Bordi me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë. Mënyra e punës dhe procedura e vendimmarrjes së Komisionit arbitrar, përcaktohen me rregullore të veçantë të cilën e miraton Bordi i Federatës.

10.3.2. Të gjitha vendimet në Komisionin Arbitrar merren me shumicë votash. Këto vendime janë të plotfuqishme nëse janë prezent në mbledhje më tepër se gjysma e anëtarëve. Anëtari i Këshillit apo Komisionit të FTK- se, i cili nuk është prezent në mbledhje, mundë të deklarohet edhe me shkrim, nëpërmjet postës elektronike apo telefaxit.

10.4. Komisioni për aktet normative

10.4.1. Komisioni për aktet normative përbëhet nga tre anëtarë, të cilët janë të zgjedhur nga Bordi i FTK-së, me një mandat katër vjeçar dhe me një mundësi të rizgjedhjes.

10.4.2. Komisioni për aktet normative të FTK-së e ka përgjegjësinë e rregullimit të të gjitha akteve normative të FTK-se, të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri me aktet normative të ETF, ITF dhe NOKK.

10.4.3. Të gjitha vendimet në Komisionin për aktet normative merren me shumicë votash. Këto vendime janë të plotfuqishme nëse janë prezent në mbledhje më tepër se gjysma e anëtarëve.

10.5. Komisioni i garave

10.5.1. Komisioni i garave përbëhet nga tre anëtarë, të cilët janë të zgjedhur nga Bordi i FTK-së, me mandat njëvjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe një herë.. Bordi i FTK-së vendos për çdo vit se a do të ketë komision apo komisar të garave duke aprovuar propozimin për gara. Aktivitetet dhe procedurat e vendimmarrjes së komisionit, janë të rregulluara me propozimin e garave të aprovuar nga Bordi i FTK-së.

10.6. Këshilli i garave

10.6.1. Këshilli i garave është organ i nivelit të dytë i Bordit të FTK-së, që përbëhet nga tre anëtarë me mandat njëvjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes për një mandat tjetër.

10.6.2. Këshilli i garave është përgjegjës të mbroj legjitimitetin e nivelit të dytë, të pakënaqësive në lidhje me mosrespektimin e propozimit të garave dhe rregullave disiplinore të nivelit të parë (nga komisioni i garave). Ku këshill i raporton Bordit të FTK-së.

10.6.3. Të gjitha vendimet në këshillin e garave merren me shumicë votash. Këto vendime janë të plotfuqishme nëse janë prezent në mbledhje më tepër se gjysma e anëtarëve.

10.7. Komisioni disiplinor

10.7.1. Komisioni disiplinor përbëhet prej tre anëtarëve, të cilët i emëron Bordi me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandat. Komisioni disiplinor vendosë në shkallë të parë në lidhje me shkeljet e Rregullores disiplinore, me të cilën më përparësisht rregullohen të drejtat dhe obligimet e Komisionit, si dhe procedura e vendimmarrjes në lidhje me shkeljet disiplinore.

10.7.2. Të gjitha vendimet në komisionin disiplinor merren me shumicë votash. Këto vendime janë të plotfuqishme nëse janë prezent në mbledhje më tepër se gjysma e anëtarëve.

10.8. Komisioni për informim dhe marketing

10.8.1. Komisioni për informim dhe marketing përbëhet nga tre anëtarë, të cilët janë të zgjedhur nga Bordi i FTK-së, ata kanë mandat katër vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

10.8.2. Komisioni për informim dhe marketing i FTK-së, ka për detyrë të rrit vlerën e FTK-së nëpërmjet informimit të opinionit në lidhje me punën e FTK-së. Kjo bëhet nëpërmjet broshurave, gazetave dhe materialeve tjera për publikim. Ky komision gjithashtu merret me marketing, nëpërmjet projekteve vendore dhe ndërkombëtare, në mënyrë që të sigurojë të hyra për aktivitetet e FTK-së.

10.8.3. Komisioni mund të punësojë njerëz në pajtim me ligjin për marrëdhëniet e punës.

10.8.4. Të gjitha vendimet në komisionin për informim dhe marketing merren me shumicë votash. Këto vendime janë të plotfuqishme nëse janë prezent në mbledhje më tepër se gjysma e anëtarëve.

10.9. Komisioni Sanitar

10.9.1. Komisioni Sanitar përbëhet nga tre anëtarë, të cilët zgjedhën nga Bordi i FTK-së me mandat katër vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër.

Komisioni Sanitar është përgjegjës për medicinën sportive, dhe për të mbrojtur shëndetin e teniserëve.

Ky komision organizon kontrolle të rregullta mjekësore të teniserëve dhe i informon ata në lidhje me rregullat dhe nenet për anti doping, nga lista e WADA (World Anti Doping Organisation), valid për vitin kalendarik.

10.9.2. Ky komision mund ta rris numrin e të punësuarve duke punësuar persona shtesë nga profilet e mjekësisë.

10.10. Komisioni për shpërblime

10.10.1. Ky komision përbëhet nga tre anëtar, të cilët janë të zgjedhur nga Bordi i KTF-së me mandat katërt vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandat.

10.10.2. Ky komision është përgjegjës për propozimin e atletëve apo institucioneve KTF-së për çmime dhe mirënjohje, në bazë të kontributit të tyre, lidhjen, punën dhe suksesin në prezantimin e sportit kosovar brenda dhe jashtë kufijve.

FTK jep këto çmime dhe mirënjohje për atletë, klube, shoqata, gazetarë të sportit dhe individë të tjerë:

- Mirënjohje
- Falënderime
- Diploma ekipore
- Diploma individuale
- Medalje (arta, argjendta, bronzta)
- FTK emblema (arta, argjendta, bronzta)
- Flamuj komemorativë
- Kupa
- Dhurata sportive dhe rekuizita
- Dhurata speciale për popullaritet, kualitet dhe fair-play.
- Dhurata speciale për gazetarë të televizionit të cilët kanë mbuluar aktivitetet e tenisit në Kosovë dhe jashtë
- Dhurata me para kesh

10.10.3. Të gjitha vendimet në komisionin për shpërblime merren me shumicë votash. Këto vendime janë të plotfuqishme nëse janë prezent në mbledhje më tepër se gjysma e anëtarëve.

11. Garat

Garat zyrtare në Kosovë mund të organizohen vetëm nga Federata, ose organi i autorizuar nga Bordi i saj. Garat zhvillohen në bazë të rregullave të FTK-së dhe rregulloreve të ETF-së dhe ITF-së. Orarin e të gjitha garave dhe rregullave e miraton Bordi i FTK-së.

12. Reprerentacionet

12.1. Federata është e obliguar të kujdeset për Reprerentacionet. Të luash për reprerentacionin e Kosovës është një obligim dhe nder për të gjithë anëtarët e saj. Federata mund të miratojë një rregullore speciale për reprerentacionet.

12.2. Ngjyrat e fanellave të reprerentacionit të tenisit të Kosovës janë të bardha me emblemën e FTK-së përpara.

- 12.3. Kategorizimi i reprezentacioneve të Kosovës në bazë të gjinisë, moshës dhe grupeve, sigurimi i lehtësive, seleksionimi i trajnerëve dhe stafit, stimulimi financiar i lojtarëve të reprezentacionit, financimi i sigurimit shëndetësor të tyre, stimulimi financiar i stafit profesional, obligimet e klubeve ndaj reprezentacionit, janë të rregulluara me rregulloren e reprezentacionit të FTK-së.
- 12.4. Selektorët e reprezentacionit janë të emëruar nga Bordi i FTK-së, bazuar në propozimet e Këshillit Profesional të FTK-së. Mandati i tyre është katër vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 12.5. Trajnerët e reprezentacionit janë të propozuar nga elektori i reprezentacionit dhe të nominuar nga Bordi i FTK-së, pas verifikimit të Këshillit profesional.
- 12.6. Në rast të nevojës për ndihmë shtesë të reprezentacionit, si përmbushja e programit të punës dhe për të zgjeruar resurset financiare, FTK mund të nominojë Drejtorin e Reprezentacionit.

13. Dispozitat financiare

13.1. Federata financohet nëpërmes:

- Anëtarësisë
- Donacioneve
- Marketingut
- Të hyrave nga garat
- Të tjera burime legale

13.2. Me menaxhimin e financave të Federatës është përgjegjës Kryetari i FTK-së, bazuar në planin financiar dhe vendimet e Kuvendit dhe të Bordit të FTK-së. Për ndihmë shtesë, rreth punëve financiare Federata mund të punësojë njerëz, në pajtim me rregulloren për punësim.

14. Shërbimi Administrativo-Profesional

- 14.1. Federata mund të punësojë staf shtesë, të cilët do të punojnë në shërbimin profesional dhe administrativ. Për punësimin e tyre dhe lartësinë e pagës vendos Bordi i FTK-së, pas propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm.
- 14.2. Federata mund të punësojë staf shtesë nëse duhet për ndihmë në udhëheqjen e ndonjë gare vendore.

- 14.3. Federata mund të punësojë staf shesë, për administratë, siç janë përkthyesit rofesionistë për gjuhë të huaja.
- 14.4. Administrata e FTK-së është përgjegjësi e Sekretarit të Përgjithshëm të FTK-së, i cili i raporton Bordit të FTK-së.

15. Rregulloret e brendshme

- 15.1. Rregulloret e brendshme dhe propozicionet e garave nuk guxojnë të pësojnë ndryshime, gjatë edicionit garues i cili është në rrjedh e sipër.
- 15.2. Në procedurat administrative që janë të lidhur me strukturat kompetente të Federatës, mund të përdoren mjete të rregullta apo mjete juridike të jashtëzakonshme. Për çështje administrative që nuk janë të rregulluara me këtë Statut, përdoren dispozitat e kodit për procedurat administrative.
- 15.3. Për të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave dhe organizatave në bashkëpunim me FTK-në, vendos Bordi i FTK-së, vetëm në rastet kur ato nuk janë të përfshira në këtë statut. Vendimet e Bordit të FTK-së që janë marr në proporcionin me paragrafin 1 të këtij neni janë finale dhe ankesë ndaj tyre nuk lejohet.
- 15.4. Kundër vendimeve të komisioneve dhe strukturave tjera të Bordit të FTK-së, mund të iniciohet ndonjë kërkesë dhe t'i dorëzohet Bordit të FTK-së, në periudhën prej 8 ditësh , prej ditës kur është marr vendimi. Bordi i FTK-së është i obliguar të vendos bazuar në Librin e Rregullativave, jo më vonë se 30 ditë prej ditës që kërkesa është bërë. Vendimi i Bordit duhet të dërgohet prapa jo më vonë se 8 ditë pas vendimit.
- 15.5. Nëse në aktin final të autoriteteve ose strukturave tjera të Bordit të FTK-së, ka ndonjë ndërhyrje në miratimin e marrëveshjes, miratimin e statutit dhe akteve tjera normative të Federatës, atëherë personi i interesuar, autoriteti ose organizata mund të iniciojë procedurën për mbrojtje ligjore. Ankesa me shkrim mund t'i dërgohet Kryetarit të Kuvendit, në periudhën 30 ditore.
- 15.6. Komisioni për Dekrete i Bordit është i obliguar që 15 ditë prej ditë së pranimit të ankesës, të përgatis shpjegim me shkrim në lidhje me atë ankesë dhe t'ia dërgojë Kryetarit të Kuvendit. Kryetari i Kuvendit është i obliguar të marr vendimin në lidhje me atë ankesë, kohën prej 8 ditësh, prej ditës së pranimit të opinionit nga Komisioni për Aktet Normative.

15.7. Kryetari i Kuvendit mund të refuzojë propozimin për kërkesë për mbrojtje ligjore, nëse ajo është prezantuar pas kalimit të afatit të caktuar. Vendimi është final dhe kërkesa shtesë nuk lejohen. Nëse Kryetari i Kuvendit dëshmon se propozimi është dërguar me kohë, ai do ta dërgoj atë propozim te Bordi i FTK-së, në periudhën prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

15.8. Në rast se vendimi në lidhje kërkesën për mbrojtje ligjore është marr, Bordi i FTK-së është i obliguar t'i dërgojë kërkesë-bërësit vendimin në lidhje me kërkesën , më së largu deri në 30 ditë.

16. Dopingu

Sipas rregullave të ITF nëpërmjet Tennis Anti-Doping Programme (the Programme), Federata i organizon garat dhe të gjithë garuesit i pranojnë si kushte për pjesëmarrje në gara.

The Programme është i përshkruar detajisht në site-in (www.itftennis.com/anti-doping) dhe në librin e rregullave të publikuar dhe të distribuuar nga ITF në Shoqatat Nacionale dhe është e pranishme nëpërmjet aplikimit për ITF.

17. Dispozitat kalimtare dhe të fundit

17.1. Ky Statut hyn në fuqi ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Federatës. Më hyrjen në fuqi të këtij Statuti pushon të vlejë Statuti i miratuar më parë.

17.2. Interpretimin e këtij Statuti e bën Kuvendi i Federatës.

17.3. Ndryshimi i rregullave:

Ky statut mund të amandamentohet me rezolutën e Kuvendit të përgjithshëm me 2/3 e shumicës së votave.

Prishtinë, 14 Janar 2012

Shkëlzen A. DOMI

Kryetar i FTK-së

domi@tenniskosova.com

www.tenniskosova.com

